

**LIGJI Nr. 05/L -043**

**PËR FALJEN E BORXHEVE PUBLIKE**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR FALJEN E BORXHEVE PUBLIKE**

**KAPITULLI I  
DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Qëllimi**

Qëllimi i këtij ligji është falja e borxheve publike ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike, si dhe përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për faljen e këtyre borxheve, që personat fizikë dhe juridikë kanë për periudhën deri më 31 dhjetor 2008.

**Neni 2  
Fushëveprimi**

Ky ligj zbatohet ndaj të gjitha Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike, që përcaktohen në këtë ligj.

**Neni 3  
Përkufizimet**

1. Shprehjet e përdorura në këtë ligj kanë këto kuptime:

1.1. **Borxh publik** – për qëllim të këtij ligji borxhi publik, nënkupton çdo shumë e papaguar e borxhit, përfshirë ndëshkimet, gjobat, interesin si dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e kryegjësë së borxhit, sipas gjendjes me datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, që kanë qenë obligim për pagesë i personave ndaj Institucioneve Shtetërore, në emër të obligimeve tatimore, doganore dhe tatimit në pronë, si dhe të gjitha obligimeve tjera financiare ndaj Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbime publike, në emër të shërbimeve të ofruara, për qytetarët në Republikën e Kosovës deri më datë 31 dhjetor 2008;

1.2. **Borxh bazë** – nënkupton shumën e borxhit kryesor (kryegjënë) pa përfshirë gjobat, ndëshkimet, interesin dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e kryegjësë së borxhit;

1.3. **Institucione Shtetërore** – për qëllim të këtij ligji nënkupton Ministrinë e Financave, Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, Administratën Tatimore të Kosovës, Doganën e Kosovës dhe Komunat;

1.4. **Ndërmarrje Publike** - nënkupton të gjitha ndërmarrjet e themeluara sipas ligjit përkatës për Ndërmarrje Publike;

1.5. **Ndërmarrje Shoqërore** – nënkupton ndërmarrjet shoqërore të përkufizuara me Ligjin përkatës për Agjencinë Kosovare të Privatizimit;

1.6. **Person** - për qëllim të këtij ligji, nënkupton të gjithë personat fizikë dhe personat juridikë privat (jo publik), që kanë shuma të borxheve publike të pashlyera ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike. Në rastet kur personi është partneritet publiko privat, falja e borxhit ndahet sipas pjesëmarrjes së partnerit privat në PPP.

## KAPITULLI II PËRFITUESIT NGA FALJA E BORXHEVE

### Neni 4 Subjektet që përfitojnë nga falja e borxheve

1. Nga falja e borxheve publike për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, sipas këtij ligji përfitojnë të gjithë personat të cilët kanë obligime të pashlyera ndaj Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike, me kusht që të njëjtit:

1.1. të kryejnë pagesën e plotë të obligimeve për periudhën nga 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014, atëherë personat e këtyre, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe me faljen e gjobave, ndëshkimeve, interesit dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e kryegjësë së borxhit për periudhën 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014, ose;

1.2. të lidhin marrëveshje me Institucionin Shtetëror apo Ndërmarrjen Publike për pagesën e borxheve me këste për periudhën 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014. Në rastin kur arrihet marrëveshja sipas nën-paragrafit 1.2 të këtij neni, atëherë personat e këtyre, përveç faljes së tërësishme të borxhit për periudhën deri më 31 dhjetor 2008, do të përfitojnë edhe faljen e ndëshkimeve për periudhën 01 janar 2009 deri më 31 dhjetor 2014. Pagesa e borxhit sipas këtij paragrafi duhet të kryhet:

1.2.1. brenda afatit prej dy (2) vitesh, për personat juridikë, nga data e lidhjes së marrëveshjes, dhe;

1.2.2. brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga personat fizikë, nga data e lidhjes së marrëveshjes.

2. Për borxhet e pashlyera deri më 31 dhjetor 2008, ku shuma totale e borxhit bazë (kryegjësë) është në vlera të vogla prej një (1) deri njëqind euro (100), nuk vlejnë dispozitat e paragrafit 1 të këtij neni dhe të njëjtat do të fshihen me automatizëm.

3. Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, të gjithë personat që nuk kanë borxhe të

pashlyera para vitit 2008, por që vendosin t'i shlyejnë obligimet për periudhën vijuese 01 janar 2009 deri 31 dhjetor 2014, sipas kushteve të vendosura në nën-paragrafin 1.1 do të përfitojnë falje të gjobave, ndëshkimeve, interesit dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e kryegjësë së borxhit, apo, nëse vendosin t'i shlyejnë obligimet për periudhën vijuese 01 janar 2009 deri 31 dhjetor 2014, sipas kushteve të vendosura në nën-paragrafin 1.2 do të përfitojnë falje të ndëshkimeve.

#### **Neni 5**

#### **Detyrimet e Institucioneve Shtetërore dhe Ndërmarrjeve Publike**

Të gjitha Institucionet Shtetërore dhe Ndërmarrjet Publike janë të detyruara që, brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, t'i identifikojnë dhe përgatisin listat e të gjithë personave, të cilët duke iu nënshtruar dispozitave të nenit 4 të këtij ligji, mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike për periudhën deri më 31 dhjetor 2008.

### **KAPITULLI III**

#### **DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

#### **Neni 6**

#### **Procedurat dhe afatet kohore për zbatim të ligjit**

1. Personat që mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike sipas dispozitave të këtij ligji, duke përfshirë edhe personat që janë në procedurë gjyqësore për borxhin e pa paguar dhe personat që kanë hyrë në marrëveshje për pagesën e borxheve deri më 31 dhjetor 2008, për ta realizuar këtë të drejtë duhet ndjekin procedurat e parapara në nenin 4 të këtij ligji.

2. Brenda tridhjetë (30) ditësh, nga dita kur një person përmbush njërën nga kriteret e përcaktuara me nenin 4 të këtij ligji, Institucioni Shtetëror përkatës apo Ndërmarrja Publike përkatëse është përgjegjëse për fshirjen e borxheve nga sistemi, duke pasqyruar këto fakte në regjistrat e tyre kontabël.

3. Pavarësisht dispozitave të nenit 4 të këtij ligji, nëse personat të cilët përfitojnë nga ky ligj përmes arritjes së marrëveshjes për pagesën me këste të obligimeve për periudhën 1 janar 2009 deri 31 dhjetor 2014, dështojnë në respektimin e kushteve të marrëveshjes, atëherë, Institucioni Shtetëror apo Ndërmarrja Publike ka përgjegjësi që të njëjtin ta vendosë në listën e borxheve, duke e bërë obligues për të gjitha borxhet e mbetura sipas kërkesave ligjore që kanë qenë të zbatueshme para lidhjes së marrëveshjes.

4. Subjektet që mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike sipas nenit 4 të këtij ligji, këtë të drejtë mund ta realizojnë brenda periudhës prej një (1) viti, nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

#### **Neni 7**

#### **Aktet Nënligjore**

Sipas propozimit të Ministrisë së Financave, Qeveria e Republikë së Kosovës miraton akt nënligjor për zbatimin e këtij ligji.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 05/L -043**  
**22 korrik 2015**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-019-2015, datë 07.08.2015 nga Presidentja e Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga**